



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA JURIDIKE  
SEKTORI I PROKURIMEVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë më \_\_\_\_\_. 2024

**PROCESVERBAL**  
**PËR HARTIMIN DHE ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE,**  
**LLOGARITJEN E FONDIT LIMIT DHE ARGUMENTIMI I TIJ**

Ky procesverbal mbahet sot më datë \_\_\_\_\_. 2024 nga Komisioni i ngritur me Urdhërin e Titullarit Nr. \_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_\_. 2024 për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit të kontratës dhe argumentimin e tij si për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje karburant për nevojat e bashkisë”** si dhe në bazë të kërkesës për fillim procedure të Drejtoria e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes me Nr. \_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_\_. 2024 (pjesë e dosjes së prokurimit).

**Specifikimet teknike dhe argumentimi i tyre:**

Komisioni ka hartuar specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi në përputhje me nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Blerje gazoil 10 ppm ULSD**

Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 590: 2013+A1:2017 sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

**Blerje benzinë**

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

**Argumentimi:**

Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish –komunave, pra zonat rurale.

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë. Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë mjetesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj.

Specifikimet teknike të lendeve djegese, objekt prokurimi janë përcaktuar referuar kërkesave dhe tipologjisë së automjeteve sipas standarteve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit ose ekuivalente, si organizmi kombëtar i standartizimit në Republikën e Shqipërisë për hartimin, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë në zbatim të ligjit nr.9870, datë 04.02.2008 “Për standartizimin”, i ndryshuar.

*Shënim: Për çdo standart ose emërtim marke të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tyre.*

### **Llogaritja dhe argumentimi i fondit limit të prokurimit:**

Komisioni ka përllogaritur fondin limit të procedurës në përputhje me nenit 34, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 12,13 dhe 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Referuar Aktit Normativ Nr. 5, datë 12.3.2022 si dhe Aktit Normativ Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Komisioni për përllogaritjen e vlerës limit të prokurimit i është referuar Bulletinit Nr.44 datë 5 gusht 2024 si mëposhtë vijon:

- Gazoil 749 \$/Ton
- Benzinë 826 \$/Ton
- Këmbimi valuator për dollarin sipas Bankës së Shqipërisë në datë 12/08/2024 është 91.6

	Elementet e cmimit	pershkrimi I mallrave
		<b>Super Benzine</b>
	<b>Densiteti</b>	<b>0.7533</b>
	<b>cmimi reuters dt.29.07.2024 + 30 \$/Ton</b>	<b>826.00</b>
	<b>kursi I \$/ALL 02.08.2024</b>	<b>91.60</b>
1	<b>Cmimi I konvertuar ne leke /liter</b>	<b>57.00</b> (Cif*densiteti*kursi \$/All)/1000)
2	<b>Aksiza</b>	<b>37.00</b>
3	<b>Takse karboni</b>	<b>1.50</b>
4	<b>Takse nacionale</b>	<b>27.00</b>
5	<b>Takse markimi</b>	<b>1.00</b>
6	<b>Fitimi i shoqerise ne vlerë ( 15 lek/lt. )</b>	<b>15.00</b>
	<b>Cmimi pa TVSH (1+2+3+4)</b>	<b>138.50</b>
	<b>Cmimi me TVSH</b>	<b>166.20</b>

	Elementet e cmimit	pershkrimi I mallrave
		<b>EURO DIESEL</b>
	Densiteti	<b>0.8352</b>
	cmimi Reuters dt.29.07.2024 + 30 \$/Ton	<b>749.00</b>
	kursi I \$/ALL me 02.08.2024	<b>91.60</b>
1	Cmimi I konvertuar ne leke /liter	<b>57.30</b> (Cif*densiteti*kursi \$/All)/1000)
2	Aksiza	<b>37.00</b>
3	Takse karboni	<b>3.00</b>
4	Takse Nacionale	<b>27.00</b>
5	Takse markimi	<b>1.00</b>
6	Fitimi i shoqerise ne vlerë (15 lek/lt. )	<b>15.00</b>
	Cmimi pa TVSH(1+2+3+4)	<b>140.30</b>
	Cmimi me TVSH	<b>168.36</b>

Sipas kërkesës për fillim procedure të **Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes** me Nr.\_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_2024 dhe Regjistrin të Parashikime të Procedurave të Prokurimit për vitin 2024 fondi për t'u prokuruar është në total 14.166.666.67 (katërbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, si mëposhte:

Vlera limit e kësaj procedurë prokurimi do të jetë 14.166.666.67 (katërbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, ku 11.018.518,52 (njëmbëdhjetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë presje pesëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH për gazoil 10 ppm ULSD dhe 3.148.148,15 (tre milion e njëqind e dyzetë e tetë mijë e njëqind e dyzetë e tetë presje pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH për benzinë Premium Unl 10 ppm .

### **Sasitë e pritshme:**

Komisioni në përlogaritjen e sasive të pritshme për secilin zë i është referuar nevojës për karburant për mjetet e transportit për vitin 2024 duke marrë në konsideratë fondin e vënë në dispozicion dhe çmimet për njësi si mëposhtë vijon:

	Fondi 2024	Cmimi njësi pa tvsh	Sasia e pritshme
<b>Gazoil</b>	11.018.518,52	140.3	78,535.4 litra
<b>Benzinë</b>	3.148.148,15	138.5	22,730.3 litra

Referuar Regjistrin të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik për vitin 2024 rezulton se është përzgjedhur procedurë prokurimi e hapur si formë juridike e finalizimit të procedurës me objekt “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë”.

## **KOMISIONI**

1. Sokrat Kreku (Kryetar)
2. Enkel Shehu (Anëtar)
3. Ylli Qurdukaj (Anëtar)